



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 01.04.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”
3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.
4. Raporti vjetor i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014.
5. Raporti vjetor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini dhe Nard Ndoka. Merr pjesë në këtë mbledhje edhe deputetja Majlinda Bregu.

Mungojnë: Oerd Bylykbashi, Tom Doshi

Të ftuar:

Besnik Dervishi - komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Pjerina Gaxha- drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Ardita Shehaj - drejtore e Drejtorisë së të Drejtës për Informim

Lefterije Lleshi- kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Denar Biba- zëvendëskryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Petrit Gjokutaj - drejtor në Drejtorinë e Informacionit dhe Teknologjisë
Dëshira Pasko - drejtore në Drejtorinë Juridike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Meqenëse kuorumi është i realizuar, mund të fillojmë mbledhjen e komisionit.

Kemi lënë vazhdimin e dekreteve nga dita e djeshme, por, meqenëse zonja Bregu, e cila është inicuese e dy iniciativave për ndryshime në Kodin Civil dhe Kodin e Procedurës Civile, është e pranishme do të sugjeroja që të fillojmë me zonjën Bregu pastaj, të vazhdojmë me çështjen e mbartur nga dita e djeshme.

Janë dy iniciativa të paraqitura prej deputetes Bregu: projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

Sot kemi çmuar që të ketë një prezantim nga zonja Bregu lidhur me dy iniciativat e sjella prej saj, për shqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë.

Të dëgjojmë relatorin në parim dhe të fitojmë pak kohë për të marrë një mendim nga Ministria e Drejtësisë, sepse është ministria përgjegjëse që mbulon çështjet e kodifikimit, nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si edhe nga disa aktorë të tjerë të rëndësishëm të kësaj fushe, e cila është paksa delikate, po e them që në fillim, dhe besoj se edhe zonja Bregu ka qenë e ndërgjegjshme për këtë, sepse ndërmjet nevojës që kemi për të parandaluar dukuri të kësaj natyre dhe raportit që kemi me lirinë e shprehjes dhe lirinë medias duhet të jetë një gjykim i kujdesshëm, për shkak të sensitivitetit që kanë çështje të tilla nga pikëpamja e rëndësisë së problemit, por edhe pasojave që mund të ketë.

Gjithsesi, nuk dua të bëj koment, por thjesht të sjell në vëmendjen tuaj ndjeshmërinë e këtij diskutimi, angazhimin dhe përkushtimin që duhet të tregojë secili për t’u përgatitur në procesin e diskutimit të këtij projektligji.

Fillojmë me një ekspozë të zonjës Bregu.

Do të propozoja t’i përmbledhnit të dyja për shkak se edhe fokusi është i njëjtë.

Zonja Bregu, ju lutem.

Majlinda Bregu – Zoti Xhafaj, faleminderit!

Faleminderit edhe për mundësinë e diskutimit, herë pas here në këtë komision të nismave të tilla që si kjo e sotmja, të cilat, në fakt, janë iniciativa që janë përkrahur nga Aleanca e Grave Deputete dhe kanë të bëjnë kryesisht me çështjen e të drejtave të njeriut, me fokus mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave.

Këto janë dy propozime të cilat unë i kam depozituar në ditën e parë, kur Aleanca e Grave Deputete u mbledh për të vendosur një platformë për të propozuar masa konkrete kundër dhunës me bazë gjinore. Dhe sikurse ju e thatë, janë dy propozime, ku njeri prek Kodin Civil për një çështje, e cila unë besoj se është shumë e ndjeshme ose që lidhet me atë që sot njihet si kultura dixhitale, ka të bëjë me respektimin dhe mos cenimin e dinjitetit të një qenie njerëzore. Në këtë rast, propozimi konkret ka të bëjë me komentet fyese e diskriminuese ndaj grave dhe zonjave, të cilat e kalojnë normën e kritikizmit normal, duke cenuar kështu, jo vetëm dinjitetin e personit, por duke sjellë edhe një mesazh negativ, i cili sipas mendimit tim është në shkelje të lirisë së shprehjes dhe jo në respekt të saj.

Duke pasur parasysh faktin që media sociale po merr gjithmonë e më shumë terren dhe hapësirat që lihen për komente pas publikimit të një lajmi janë gjithmonë e më të mëdha, është e pamundur për t'i kontrolluar, sikurse është e pamundur për një subjekt për të qenë gjithmonë *online* dhe për të parë nëse ka komente denigruese për personalitetin e tij. Megjithatë, duke dashur të përafrojmë një praktikë të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në lidhje me lirinë e shprehjes dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, pra ky nuk është një propozim që vjen në boshllëk, ka një praktikë ligjore të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për një çështje që lidhet me një kompani në Estoni ndaj së cilës gjykata është shprehur se kjo kompani është përgjegjëse për përdorimin e komenteve diskriminuese dhe fyese në faqen e portalit të saj.

Gjithashtu, po me një vendim të miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, në vitin 2003, specifikohet se “Liria e komunikimit në internet nuk duhet të paragjykojë dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të të tjerëve”.

Duke marrë në konsideratë thënë sa më sipër, besoj se është e nevojshme gjetja e një balance ndërmjet respektimit të vullnetit të përdoruesve të internetit, por nga ana tjetër, edhe nevojës që një autoritet ligjzbatues duhet të jetë në gjendje që të bëjë kontrollin e këtyre komenteve dhe sigurisht të përcaktojë edhe përgjegjësitë.

Ndaj propozimi i parë ka të bëjë me një përgjegjësi që i ngarkohet administratorit të portalit online, duke përcaktuar mënyrat dhe masat e nevojshme që duhet të ndërmerren nga administratorët e faqeve online për fshirjen në kohë të komenteve, që cenojnë nderin, reputacionin dhe personalitetin e një individi. Për kënaqësinë e qeverisë, ky ligj nuk ka asnjë efekt financiar, ndaj nuk ka pse të shqetësohet.

Kështu që besoj se duke pasur mirëkuptimin tuaj, duke respektuar edhe të gjithë pjesën e marrjes së mendimit nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të të Dhënave, unë do ta shihja me vend, si një masë të nevojshme, qoftë edhe për të

përcjellë një mesazh të domosdoshëm të respektimit të lirisë së shprehjes të medias, por edhe të respektimit të dinjitetit të një individi.

Projektligji i dytë, i cili është përsëri propozim për Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.8116, është një nismë ligjore, e cila, në fakt, më saktë, e kam artikuluar nisur nga shqetësimet që dëgjojmë çdo ditë, për të adresuar një problematikë, e cila zvarritet tashmë prej vitesh në sistemin tonë gjyqësor dhe që është ajo e përcaktimit të detyrimit ushqimor për fëmijët në rastet e divorcit.

Pavarësisht ndryshimeve dhe përmirësimeve që i janë bërë në këtë drejtim, shpesh janë hasur problematika në çështjen e përcaktimit të detyrimit ushqimor, duke prekur drejtpërsëdrejti mirëqenien e fëmijëve dhe interesin më të lartë të tyre. Kryesisht kjo gjë vihet re në rastet kur fëmijët lihen në kujdestari të nënave. Duke mos neglizhuar barrën e rëndë emocionale me të cilën zakonisht shoqërohen rastet e divorceve dhe pasojat që kanë te fëmijët, besoj se, është jo vetëm e pandershme, po hezitoj të përdor ndonjë fjalë më të rëndë, që në një proces divorci ndërmjet dy adultëve të cenohet e drejta e jetesës dhe e dhënies të paktën të minimumit jetik për fëmijët që gjykata përcakton si detyrim për njërin prind.

Ndaj, me propozimet në këtë projektligj synoj të adresoj çështjen e detyrimit ushqimor për fëmijët, i cili, në fakt, duhet të jetë automatik dhe të mos ketë një periudhë në mes, e cila të jetë vakuum, por të nisë paralel me procesin e zgjidhjes së martesës, duke mos lënë të nënçmuarjen dhe vlerësimin e gjyqtarit dhe kërkesës së palëve, por duke i qëndruar bindjes se detyrimi ushqimor për fëmijët është një përgjegjësi e prindërve ndaj fëmijëve dhe si i tillë duhet të vendoset automatikisht me nisjen e procesit.

Gjithashtu, duke parashikuar detyrimin gjykatës që të marrë në shqyrtim përcaktimin e detyrimit ushqimor për fëmijët në momentin e nisjes së procedurave për zgjidhjen e martesës dhe duke mos e lënë këtë prehë të apelit të procedurave të një vendimi të mëpasshëm apo, e përsëris, nënçmuarjen e gjyqtarit apo të prindit, i cili mund të mos ketë dëshirë, duke mosllogaritur edhe vetëm mundësinë të kërkojë dhe të apelojë vendimin. Ai që vuan në këtë rast është fëmija ose fëmijët.

Këto janë dy iniciativat ligjore, thënë shkurt.

Në rast se do të keni pyetje, jam këtu.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zonja Bregu!

Ky komision ka qenë gjithmonë mikpritës për iniciativat e kolegëve deputetë jo thjesht dhe vetëm se është një e drejtë kushtetuese, por, sepse mendoj se është e rëndësishme për rolin që duhet të luajnë deputetët në procesin ligjvënës e jo vetëm në aspektin mbështetës

apo debatues në projektet e sjella nga qeveria, por edhe në aspektin për të qenë proaktiv në të gjithë këtë proces.

Unë jam shumë i bindur që ky komision do të vazhdojë të mirëpresë iniciativat e kolegëve deputetë, ashtu si ka mirëpritur edhe deri tani përkundër anatemimeve që mund të kenë pasur në rastet e veçanta për iniciativat e disa kolegëve deputetë, anëtarë të këtij komisioni, por në politikë ndodh gjithçka.

Kurse ju, zonja Bregu, në rastin konkret, të jeni e sigurt se keni mirëkuptimin e maxhorancës, jam i bindur që qeveria nuk është e shqetësuar për efektin financiar të nismave tuaja, por beson në qëllimin pozitiv të tyre.

Zonja Hysi, e ka fjalën, në cilësinë e relatores.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Po i marr nismat me radhë, sepse trajtojnë dy çështje të ndryshme që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, por në fakt grupi përfitues është grupi i grave dhe i fëmijëve.

Nisma e parë ka të bëjë me ndryshimin e Kodit Civil dhe konkretisht trajton një nga shqetësimet më të mëdha me të cilat përballet sot Shqipëria, por edhe Europa. Është pikërisht raporti midis lirisë së shprehjes dhe të drejtës që ka media qoftë ajo e shkruar audiovizive...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem një moment, nuk është te Kodi Civil, ke të drejtë, por do t'i marrim të dyja bashkë t'i gjykojmë. Meqenëse nuk do t'i gjykojmë veç e veç, prandaj e përmendi edhe çështjen e përfitimit të subjektit kryesor, përfituesit janë gratë dhe fëmijët.

Vasilika Hysi – Dhe në këtë kuadër, kërkohet të bëhet një ndërhyrje në Kodin Civil për të zgjidhur një problem që ka të bëjë me përgjegjësinë e dëmit jo pasuror që shkakton për administratorët e faqeve të blogjeve bashkë me komentuesit, në rast se cenohet nderi dhe dinjiteti i çdo individi.

Në fakt, Majlinda propozon katër gjëra, të cilat janë çështje të rëndësishme dhe delikate.

E para, kërkon të përcaktohet përgjegjësia e administratorit të një portali elektronik që ai të pengojë publikimin e komenteve që cenojnë nderin, personalitetin dhe reputacionin e një personi.

E dyta, sugjeron një përgjegjësi solidare të administratorit dhe të komentuesit.

Duke qenë se shpesh komentuesit nuk janë të identifikuar me adresat e tyre reale, në nismën e depozituar kërkohet që të vendoset detyrimi i administratorit të portalit që ta fshijë atë dhe të botojë në faqen e tij të dhëna se si mundet që qytetarëve që uështë cenuar nderi, reputacioni dhe personaliteti të adresojnë ankesën dhe të fshihet ajo.

E fundit, përcakton disa detyrime për autoritetin përgjegjës të komunikimeve elektronike që të kontrollojë zbatimin e këtyre detyrimeve.

Unë në parim jam me shqetësimin që ngre zonja Bregu që sot nderi, reputacioni, personaliteti i çdo individi jo vetëm të atyre që janë në politikë, cenohet rëndë.

Po të lexoni komentet, bloget në gazeta të ndryshme edhe në web- et e medieve kombëtare apo jo kombëtare, sheh çudira fyerjesh, shpifjesh, por mbi të gjitha një gjuhë urrejtje dhe propozimi që sjell zonja Bregu nuk ndalet te gjuha e urrejtjes ose te gjuha e krimit dhe urrejtjes për shkak të motiveve raciale, feje, etnie, e të tjera, por e sheh problemin shumë më të gjerë.

Në fakt, Këshilli i Europës është në proces të përgatitjes së një rekomandimi për t'ua adresuar shteteve anëtare të saj se si mund të ndalet gjuha e urrejtjes në faqet e internetit, por njëkohësisht ka edhe një direktivë të BE-së të vitit 2003, e cila orienton shtetet anëtare të BE-së dhe Shqipërinë si vend kandidat për të marrë masa për të zgjidhur një problem të tillë.

Unë e thashë që në fillim që kjo çështje është delikate për faktin se kemi të bëjmë tashmë me raportin e lirisë së shprehjes së individëve, të medias nga njëra anë, por edhe të drejtën për të respektuar dinjitetin e individëve nga ana tjetër.

Unë në relacion ju kam sjellë të gjithë bazën ligjore kryesore që ekziston në Shqipëri, duke filluar nga neni 10 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenin 22 të Kushtetutës, por ju kam bërë edhe një përmbledhje të legjislacionit civil administrativ, penal shqiptar që rregullon këtë çështje. Këtë e kam bërë jo se ju nuk i njihni, por e kam bërë për t'ju tërhequr vëmendjen që komisioni ynë e ka pasur shqetësim këtë problem.

Më lejoni, të nderuar kolegë, t'ju përmend që në vitin 2012 ne kemi bërë një ndryshim shumë të rëndësishëm në Kodin Civil duke amenduar nenet 617, 115, 625 dhe kemi shtuar një nen 647/a, ndryshime të cilat kishin të bënin me fyerjen, shpifjen dhe keqpërdorimin e saj ndaj individëve, qoftë nga media apo edhe nga individë të veçantë. Konkretisht, në vitin 2012 në Kodin Civil kemi njohur të drejtën që personi që mendon se është cenuar të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit jo pasuror, për cenimin e nderit, personalitetit dhe reputacionit brenda një viti, ndërkohë që për paditë e tjera është deri në 6 muaj. Kemi përcaktuar qartë raste kur personi mund të kërkojë dëmshpërblim jo pasuror, njëkohësisht kemi përcaktuar dhe mënyrat dhe kriteret e përgjegjësisë administrative.

Pra, deri diku, shqetësimin e zonjës Bregu e kemi adresuar në ndryshimet që janë bërë në vitin 2012. Njëkohësisht kemi bërë një ndërhyrje në Kodin Penal në nenet 119 dhe 120 ku kemi hequr dënimin me burgim dhe kemi lënë vetëm dënimin me gjobë, sepse ka pasur një rekomandim të KE-së, të përsëritur ndaj të gjitha vendeve anëtare të KE-së, por sidomos

Shqipërisë, që mediet dhe komentuesit të mos dënohen me dënime penale, por të ketë vetëm dënime civile.

Gjithashtu, në kuadër të rekomandimeve që ka bërë Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës, dhe detyrimi që na buronte nga miratimi i konventës për krimin kompjuterik dhe të protokollit shtesë të saj, të protokollit 12 për të ndaluar diskriminimin për shkak të ksenofobisë, racizmit, nëpërmjet rrjeteve kompjuterike, kemi bërë një sërë ndryshimesh në Kodin Penal, të cilat parashikojnë si vepër penale fyerjen dhe shpifjen nëpërmjet sistemit kompjuterik.

Në vitin 2008 kemi miratuar një ligj “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili është amenduar në vitin 2012, dhe këtu neve na ka shpëtuar adresimi i shqetësimit që zonja Bregu ngre, pasi do të ishte me vend të kishim ndërhyrë në këtë ligj që rregullon komunikimin elektronik për t’iu adresuar detyrimet administratorëve për të fshirë, për të pasur të drejtën e ankimimit të qytetarit, për të bllokuar *site* që kanë gjuhë urrejtjeje, shpifjesh, fyerjesh dhe që denigrojnë qytetarët.

Nga ana tjetër në vitin 2012 kemi miratuar ligjin për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Në këtë ligj kemi futur një nen që është një risi shumë e mirë, konkretisht nenin 53, që parashikon të drejtën e ankesës së qytetarëve për të kërkuar fshirjen e komenteve që mund të bëhet në faqet e gazetave dhe medieve audiovizive.

Mirëpo, po ta shikoni, të krijohet ideja që gjithçka është rregulluar, por në fakt, nuk është rregulluar gjithçka. Kemi lënë portalet elektronike, komentet e gazetave, të cilat shpesh herë administratorët e medieve i përdorin për të tërhequr sa më shumë klikime, për të nxjerrë përfitime, për të pasur sa më shumë audiencë.

Në këtë kudër, për të diskutuar propozimin e koleges Bregu, që prek një çështje tej mase të rëndësishme, që duhet rregulluar dhe që është delikate, duhet t’u japim përgjigje disa pyetjeve. Kush e përcakton se komenti i bërë nuk është në ushtrim të lirisë së shprehjes për nderin dhe dinjitetin e personit? Kush vlerëson se një koment i bërë është cenim i personalitetit që viktimja mendon se është i rremë dhe ka fakte të pavërteta? Kush do ta përcaktojë se ku ndodhet ai që komenton? Të mos harrojmë se një pjesë e faqeve nuk administrohen në Shqipëri, por jashtë territorit të saj. Si mund të kapërcehen vështirësitë për të përcaktuar përgjegjësinë qoftë solidarë apo të administratorit në rastet e faqeve të tilla, sidomos të facebook-ut ose të faqeve të tjera, të twitter-it google-it e të tjera? Gjithashtu, është pak delikate sepse duhet ta delegojmë përgjegjësinë civile, të një personi që fyen, shpif e denigron dikë tek administratori, ndërkohë që ne e kemi të rregulluar tashmë?

Në këtë kuadër do të doja që të tërhiqja vëmendjen se ka një sërë rekomandimesh evropiane në fushën e lirisë së shprehjes. Zonja Bregu, tha që ka një çështje në gjykatën e Strasburgut, çështja Delhi kundër Estonisë. Në fakt çështja nuk ka përfunduar. Është ankumuar në Dhomën e Madhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Mendoj se ka pasur një reaksion ndërkombëtar për vendimin që dha Gjykata e Strasburgut dhe me të drejtë gjykata ka vendosur ta shqyrtojë në Dhomën e Madhe të saj. Pikërisht ne duhet të mbajmë parasysh këtë çështje, e cila është në proces dhe nuk ka përfunduar.

E dyta, e thashë edhe pak më parë, Komisioni European kundër Racizmit e Intolerancës ka diskutuar në muajin mars draftin e një rekomandimi për gjuhën e urrejtjes dhe cenimin e dinjitetit të njerëzve nëpërmjet faqeve online. Besoj se nga qershori do të miratohet nga komiteti i ministrave edhe ky rekomandim. Unë kam marrë parasysh draftin për ta ndihmuar nismën që ta miratojmë dhe ta mbështesim atë, njëkohësisht të mos harrojmë që ka shumë rekomandime se si ne mund të ndërhyjmë te ligji “Për komunikimet elektronike”, te ligji “Për mediet audiovizive”, duke kërkuar që mediet të vetërregullojnë nëpërmjet kodeve të sjelljes, kodeve të etikës, detyrimet që kanë për të ruajtur dinjitetin, reputacionin, personalitetin e individëve, detyrimin që kanë administratorët e këtyre faqeve për ta fshirë, detyrimin që kanë për të vendosur atë që quhet butoni i ankesës, që, nëse një person sheh që është cenuar, të shtypë butonin e ankesës për të kërkuar bllokimin e tij dhe për të fshirë pastaj çdo *site* që ka të bëjë me gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes.

Unë, në konsultim edhe me kryetarin e komisionit dhe me këshilltarët e Komisionit të Ligjeve ua kam nisur nismat e koleges Bregu të gjitha institucioneve dhe profesorëve, ekspertëve të fushës, të cilët e kanë mirëpritur dhe kanë quajtur me interes. Më lejoni, zoti kryetar, të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen që i kanë vlerësuar të gjithë, sepse e kanë konsideruar adresimin letrës suaj si një vlerësim jo thjesht si specialistë, por edhe përfshirjen e tyre në debat, që është shumë sensitiv në të gjithë Europën për momentin që ne flasim, sidomos pas çështjes Delhi kundër Estonisë. Aata janë të treguar të gatshëm për t’u dëgjuar nëse ne marrim një vendim ose për të shprehur me shkrim të gjitha opinionet e tyre, vetëm do të doja të theksoja se nisma e zonjës Bregu, duhet falënderuar. Është quajtur shumë interesante e ardhur në kohë por shumë delikate. Pra, kërkon një konsultim shumë më të gjerë, jo vetëm të Ministrisë së Drejtësisë, por edhe të kolegëve, ekspertët e fushës.

Unë e kam mbështetur si nismë. Sikurse e tha edhe zonja Bregu, duhet t’i japim fund denigrimit që u bëhet qytetarëve, nuk e kemi fjalën për ne që jemi të përfshirë në politikë, por në përgjithësi për qytetarët.

Prandaj, kërkoj, të nderuar kolegë, të jemi të kujdesshëm në këtë nismë që të konsultohemi dhe të bëjmë ndryshimet përkatëse në përputhje me praktikën e Gjykatës Europiane, të Luksemburgut dhe me të gjitha rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

Ndjesë që u zgjata, por është çështja më e rëndësishme, nuk e di sa e ka kuptuar media apo kolegët këtë çështje që po e diskuton parlamenti në këtë fillimviti.

Të kaloj te tjetra, zoti kryetar apo do të bëjmë pyetje?

Nisma e dytë kërkon një ndërhyrje në Kodin e Procedurës Penale. Është nismë shumë e rëndësishme, përsëri nismë e depozituar nga kolegja Bregu.

Çfarë problemi ka dalë në praktikë? Ka dalë një problem shumë i madh. Interesat e fëmijëve mbahen peng i interesave të prindërve dhe shpesh problemet që kanë prindërit në proces divorci transmetohen në mënyrë të padrejtë te fëmija dhe fëmija përdoret si mollë sherri midis dy të rriturve për konfliktet që ata kanë mes tyre. Në fakt, propozimi që sjell zonja Bregu nuk është i ri, është i rregulluar në Kodin e Procedurës Civile, por gjykata nuk e ka taksative, e lë si një mundësi. Me të drejtë zonja Bregu tha që ky problem u ka kushtuar shumë fëmijëve, sepse proceset e divorcit zgjasin gjatë, dhe ndërkohë që ato që humbasin janë fëmija dhe nëna. Fëmija do të hajë që ditën e parë, kur prindërit vendosin që të divorcohen. Në këtë kuadër, nisma kërkon detyrimin e gjykatës për të vendosur në çdo rast për ekzekutimin e përkohshëm të një vendimi që përmban detyrim ushqimor.

Unë kam një pyetje për zonjën Bregu, sepse në relacion është nisur për të mbrojtur interesin e fëmijës, por nga ndryshimi që bën, i heq këtë lloj mundësie gjykatës për persona të tjerë që mund të jenë prindër, persona në ngarkim, persona me aftësi të kufizuara dhe e kalon për të gjithë në nismë, ndërkohë që te relacioni e thotë vetëm për fëmijët. Pra, duhet sqaruar ky moment. Duhet ta amendojmë nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile dhe ta bëjmë të detyrueshëm në të gjitha rastet, pra jo vetëm kur flitet për ushqim për fëmijët, por edhe për personat e tjerë, të cilët mund të jenë prindërit, bashkëshorti, personat e paaftë, apo do ta lëmë vetëm për fëmijët? Por ky ndryshim që propozon zonja Bregu pa dashje, dhe unë e mirëkuptoj, sepse nuk është juriste, bie ndesh me një rregullim që bën Kodi i Familjes, konkretisht me nenin 139 të Kodit të Familjes, i cili flet për marrjen e masave të përkohshme dhe thotë që gjykata me kërkesën e palës së interesuar mund të marrë masa të përkohshme për detyrimin për ushqim, edukim dhe arsimim. Unë këtë nismë, zoti kryetar, siç jeni në dijeni, edhe me mbështetjen tuaj ua kam nisur kolegëve që janë specialistë të fushës, përveç Ministrisë së Drejtësisë që është e detyruar që të shprehet, sepse do të preket një kod që votohet me shumicë të cilësuar, por nga ana tjetër kërkon që të koordinojmë ndryshimet në Kodin e Procedurës

Civile me ndryshimet në Kodin e Familjes, përndryshe këto dy kode na bien ndesh me njëra-tjetrën,.

Unë në parim jam dakord që ky rregullim të bëhet dhe rezervoj të drejtën që nën për nen të bëjmë rregullimet me qëllim që të mos bjerë ndesh Kodi i procedurës Civile me Kodin e Familjes por të rregullojmë edhe përmbajtjen e nenit 317 që synohet të cenohet nga nisma e zonjës Bregu.

Të nderuar kolegë, me këto dy nisma ne do të zgjidhim dy çështje shumë të rëndësishme sensitive jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Europë, nga ana tjetër do të përmbushim disa detyrime që rrjedhin nga konventat që ne kemi ratifikuar dhe që për fatin tonë të mirë Shqipëria është në avancë në ratifikimin e tyre, por ne kemi boshllëqe në përafrimin e legjislacionit, sidomos të kodeve. Duke qenë se komisioni për Reformën në Drejtësi po punon jashtëzakonisht mirë, kjo do të ishte shumë e nevojshme, zoti kryetar, edhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Reformës në Drejtësi që Ministria e Drejtësisë të mbajë parasysh edhe rregullimet e tjera që lindin në Kodin e Familjes, në Kodin Civil në Kodin e Procedurës Civile për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijëve.

Unë do të doja të ndërprisja prezantimin këtu dhe t'ju falënderoja për mbështetjen që na keni dhënë në diskutimin e këtyre dy nismave, të falënderoja zonjën Bregu, por edhe për dëgjuesat që kemi bërë dhe mundësinë që mund të na jepet për të bërë konsultim të gjerë me ekspertët e fushës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje?

Po, zonja Caka.

Silva Caka - Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Bregu, paragrafi i katërt i nenit 617/1 të Kodit Civil nis me fjalinë: “Nëse shkruesi i komentit është një person i identifikueshëm, përgjegjësia e administratorit të portalit elektronik është solidare së bashku me të”. Mua personalisht më duket censurë, kjo gjë, me thënë të drejtën, pasi duhet t'i bjerë administratorit të portalit dhe jo komentshkruesit. Ky i fundit mund të shkruajë një koment, është mendimi i tij, por është përgjegjësia e administratorit, i cili duhet ta fshijë ose jo.

Ju mendoni se është censurë kjo gjë apo jo?

Fatmir Xhafaj - Po, zonja Bregu.

Majlinda Bregu - Faleminderit!

Do të përgjigjem zonja Silva, por më lejoni të falënderoj edhe zonjën Vasilika për punën e kujdesshme dhe me shumë pasion për t'i shqyrtuar në detaje të dyja iniciativat.

Unë jam e bindur se kjo është një çështje sensitive, po aq sa jam e bindur se respektimi i dinjitetit njerëzor është më sensitive sesa cenimi i sensitivitetit të administratorëve të portaleve *online* për të publikuar komente, të cilat janë sensitive për dinjitetin, sepse janë denigruese.

Për të mos e konsideruar këtë si lojë fjalësh, besoj se të dyja propozimet, por kryesisht ai i pari që ka të bëjë me mediet *online*, në perceptimin tim nuk është cenim dhe as censurë e lirisë së shprehjes. Për një arsye të thjeshtë, ky nuk është një propozim, i cili të cenojë të drejtën e administratorëve, të gazetarëve, të medieve *online* apo të komentuesve të regjistruar, që në rastin më të madh janë anonimë, nuk janë të regjistruar, në rast se janë të regjistruar portali *online* duhet të ketë një *database* të personit të regjistruar, duhet të ketë marrjen e informacionit për personin që regjistrohet me numër kontakti, identifikimin e tij, sepse personi mund të regjistrohet me një emër, por askush nuk e vërteton dot nëse është anonim apo jo. Pra, edhe kjo është një procedurë për të evidentuar atë që mund të jetë komentues fals, apo atë që mund të jetë i vërtetë, pra anonim nga i vërteti. Të them të drejtën, nuk e kam menduar si një propozim, i cili cenon të drejtën e medias për t'u shprehur, por e kam menduar si një propozim, i cili cenon të drejtën e individëve anonimë apo të deklaruar dhe të administratorëve të faqeve *online* për të publikuar komente denigruese. Nuk flas për komente mbi lajmin apo qëndrime kritike, por për komente, të cilat kalojnë nga etiketimet, te fyerjet, te gjuha e urrejtjes, te gjuha seksiste, e cila kryesisht prek gratë, vajzat dhe jo vetëm. Besoj se qëllimi është pak më shumë sesa ai i vështirimit të çështjes vetëm në këndvështrimin nëse ka apo jo liri të shprehurit dhe deri ku shkon liria e atij që publikon *online* një koment. Nuk besoj se asnjëri nga ne nuk e ndjen, por mos harroni dhe këtu lidhen të dyja iniciativat, që në rast se të rritur kanë të tjera mekanizma mbrojtës ndaj vetes, fëmijët apo minorenët, të cilët janë sot gjithë ditën në internet, nuk kanë mekanizmin mbrojtës, qartësues dhe sqarues për të pranuar komente fyese, denigruese për prindin, të afërmin, motrën e kështu me radhë.

Me të njëjtin këndvështrim shoh edhe propozimin e dytë. Për pjesën e detyrimit ushqimor, pavarësisht se ishte iniciativë dhe është propozuar nga unë, nuk e kam ngritur pa u konsultuar me juristë. Jam shumë dakord të ketë një këndvështrim, por kjo është mangësia e përgjithshme e jona për lidhjen ndërmjet Kodeve dhe pjesëve të veçanta të legjislacionit.

Jam shumë dakord të ketë një këndvështrim nëse ka pikëprerje apo konfliktuohet me nene të veçanta të Kodit të Familjes, sikurse ju falënderoj, sepse pa dashje nuk e dija se kisha hapur një debat kaq të madh intelektual edhe ndërmjet komunitetit të juristëve, por me sa duket është një çështje e cila ka nevojë për adresim.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje për zonjën Bregu në lidhje me përcaktimin e disa përgjegjësi që duhet të kenë ata që ofrojnë shërbime. A mundemi ne që atë lloj përgjegjësie, siç thatë ju për fshirjen, për butonin e ankesës t'i përfshijmë te ligji "Për komunikimet elektronike" dhe jo në Kodin Civil, sepse te ky i fundit ne e kemi rregulluar tashmë përgjegjësinë për dëmin jo pasuror?

Nga ana tjetër shqetësimi ose pyetja që bëri zonja Caka, ka gjetur rregullim në ligjin "Për komunikimet elektronike", pasi në ndryshimet që i kemi bërë këtij ligji në vitin 2013, kemi përcaktuar detyrimin që çdo ofrues shërbimi i internetit të bëjë regjistrimin e çdo personi dhe ka detyrimin t'i fshijë, por duhet të përcaktojmë më mirë përgjegjësitë te ligji "Për komunikimet elektronike".

Kemi një ligj tjetër atë "Për mediet audiovizive", nenin 53, që mua më duket shumë mirë i rregulluar, por ndoshta duhet të ndërhyri më mirë për të përcaktuar përgjegjësitë administrative që kanë përfaqësuesit e medieve të televizioneve kombëtare dhe atyre të tjera që kanë *web*-e, ku fusin lajme dhe njerëzit fillojnë të bëjnë komente në *blog*-e për t'i fshirë, për të futur butonin e ankesës, për të fshirë komentin, për të kontaktuar personin e të tjera dhe për të stopuar të gjitha komentet ose adresat që janë të rreme. Pjesa më e madhe e adresave janë të rreme.

Në këtë kuadër nuk e kisha pritur të kishte kaq diskutim në rrethin e juristëve dhe një interesim të madh, por edhe një vlerësim për Komisionin e Ligjeve që ka adresuar këtë kërkesë, sepse është çështje e rëndësishme, ku të gjithë preken nga media ose komentatorët që përdorin mediet, por nga ana tjetër duhet të kemi kujdes, me atë që thuhet: liria e shprehjes. Deri ku do të shkojë liria e shprehjes së individit? Të mos cenohet të drejtat tona. Këtu është momenti që si në Europë edhe ne t'i themi: ndal. Të vendosim një balancë. Pyetja është, a mund të ndërhyjmë te ligji "Për mediet audiovizive"? A do të ishte e mjaftueshme të ndërhyjmë te ligji "Për komunikimet elektronike"? Të ngarkojmë AKEP-in me disa detyrime për administratorët e këtyre faqeve dhe ta linim Kodin Civil ashtu siç e ka rregulluar përgjegjësinë, sepse është i rregulluar jashtëzakonisht mirë në vitin 2012.

Zoti Xhafaj e di shumë mirë se kemi bërë një konsultë shumë të zgjeruar në atë kohë me ministrin e Drejtësisë, me ekspertë, ishte nismë e opozitës së sotme, që ishte në maxhorancë, por që u mbështet nga ne që ishim në opozitë. Bëmë një ndërhyrje shumë të kujdesshme në nenin 647 dhe shtesës që i bëmë në Kodin Civil.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Bregu.

Majlinda Bregu - Zonja Hysi të jem e singertë ky nuk është problemi apo halli im, se në cilën pjesë të legjislacionit do të rregullohet. Për mua mjafton të qëndrojë dhe të jetë një çështje që do të kufizojë këtë lloj keqpërdorimi të lirisë së të shprehurit dhe nga ana tjetër ka nevojë për të përcaktuar autoritetin përgjegjës, i cili as sot nuk është i ndarë. Në rast se sot ka një autoritet përgjegjës për medien audiovizive, ka një autoritet përgjegjës për komunikimet elektronike, por në dijeninë time, as AKEP-i, (AMA jo dhe jo, sepse nuk po flasim për medien televizive, por po flasim për medien *online*) që është përgjegjës për komunikimet elektronike nuk e ka të rregulluar pjesën e përcaktimit të një portali *online*, të bllokimit të tij, në rast se nuk e respekton këtë të drejtë. Pra, nuk është i përcaktuar si autoriteti, i cili bën kontrollin, monitorimin dhe është përgjegjës për të marrë masat ndaj të tilla shkeljeve.

Besoj se ndoshta duhet një rishikim në ligjin “Për komunikimet elektronike”, duke përcaktuar një përgjegjësi të qartë se cili do të jetë autoriteti që në fund të ditës, në rast se një portal *online* nuk e respekton këtë detyrim, të marrë masat dhe të ketë mundësi të përjashtojë dhe t’i kufizojë lirinë e përdorimit apo të aksesit në faqe, si edhe forma të tjera.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Subashi.

Armando Subashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dashur të bëj komente për thelbin e propozimit që ka ardhur, pasi unë në një mënyrë të përgjithshme pak a shumë e mbështes këtë iniciativë, jam me këtë lloj kufizimi që në të gjitha komentet që bëhen, duhet të ketë një lloj përgjegjshmërie ndaj kujtdo.

Ndërhyrjen e kam më shumë në aspektin procedural, ndoshta për të fituar disa ditë kohë, sepse duhet të jemi të kujdesshëm.

Po të shikojmë Kodin Civil, aty ku kërkohet të ndërhyhet, te neni 617 parashikohet përgjegjësia e një personi ndaj një personi tjetër për shkak se ka publikuar të dhëna të pasakta, jo të plota, ose mashtroese. Këtu parashikohet e drejta e personit për t’iu drejtuar gjykatës dhe e drejta e gjykatës për të vendosur përgënjeshttrimin e këtyre të dhënave.

Po të shikojmë pak më poshtë te neni 625, ku është përgjegjësia për dëmin jopasuror, i cili është një nen që është ndryshuar në vitin 2012, germa “b” thotë: “Personi që pëson dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet, kur është cenuar nderi personaliteti ose reputacioni i tij”.

Nëse shtrojmë pyetjen, se si mund të cenohet nderi, dinjiteti, reputacioni e të tjera, pa dyshim që format janë nga më të ndryshmet. Një nga ato forma është edhe kjo që diskutojmë ne.

Te neni 647, germa “a” që është një shtesë që i është bërë Kodit Civil në vitin 2012 janë dhënë disa modalitete ose është zbërthyer më mirë i gjithë ky institut i së drejtës civile, ku përcaktohen mënyrat, kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe masa e dëmit jopasuror. E gjithë vëmendja në këtë nen është përqendruar te dëmi jopasuror për cenimin e nderit, të personalitetit ose të reputacionit të personit. Jepen disa mënyra se si bëhet vlerësimi, si konsiderohet nëse ky dëm ekziston ose jo e kështu me radhë.

Nisur nga të gjitha këto, ndoshta Kodi Civil i ka përmbushur në një lloj kuptimi të gjitha detyrimet e veta në këtë drejtim, ndërsa norma që propozohet është më shumë një normë me karakter procedural, sesa me karakter material.

Unë do ta mbështesja deri diku, por këtë nuk e quaj si një mendim timin përfundimtar, sepse ndoshta duhet të marrim pak ditë kohë.

Do të mbështesja idenë e hedhur që kjo dispozitë që propozohet mund të qëndrojë më mirë te ligji bazë, te ai “Për komunikimet elektronike”, aty të vendosen këto lloj modalitetesh, këto lloj detyrimesh për të gjithë administratorët e faqeve *online* e kështu me radhë. Pastaj nëse nuk zbatohen, është e lehtë çdo njeri t’i referohet dispozitave të Kodit Civil për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Të gjitha këto përfundojnë në gjykatë. Kjo e fundit e ka të zgjidhur në këtë rast problemin, sepse dispozitën materiale e gjen te nenet që sapo lexova, ndërsa kufizimin dhe momentet procedurale i gjen te ligji bazë. Pra, mendoj se kjo gjë është e zgjidhur. Besoj se disa ditë kohë do të jenë të mjaftueshme për të bërë një gjë të plotë dhe të saktë në këtë drejtim.

Për nismën e dytë, për atë që ka të bëjë me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile do të thosha se parimisht jam dakord me thelbin e propozimeve, sepse janë dy momente që parashikohen këtu, ato që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga një kontratë pune, pavarësisht nëse ajo mund të jetë e rregulluar nga Kodi i Punës apo nga ligji “Për shërbimin civil”, sipas rasteve, por sa here që mund të kemi një padi në gjykatë për një dëmshpërblim të caktuar për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara e kështu me radhë, mundet që ne t’ia lëmë këtë dritare të hapur gjykatës, që nëse e çmon, mund të vendosë një masë me ekzekutim të përkohshëm kur konstaton se kushtet ekonomike financiare të paditësit ose të punëmarrësit mund të jenë të tilla që e bëjnë shumë të vështirë jetesën e tij nga pikëpamja ekonomike, këtu mund të ndërhyhet. Kjo ka një problem, sepse këtu duhet të kemi parasysh se kemi edhe një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë, i cili po e them me pak fjalë ka parashikuar që atje, në padinë e themelit kërkohet një dëmshpërblim i caktuar, vendosja e këtij dëmshpërblimi me një masë të përkohshme, ndoshta nuk mund të ishte e udhës, sepse pyetja që shtrohet është kjo: po

në rast se në përfundim gjykata nuk i jep të drejtë paditësit, vendos rrëzimin e padisë, nuk vendos asnjë lloj dëmshpërblimi, as edhe një pagë mujore, atëherë çfarë mund të bëhet me lekët ose me këtë dëmshpërblim që paditësi mund t'i ketë marrë nëpërmjet ekzekutimit të përkohshëm? A duhet t'i kthejë mbrapsht pastaj, në rast se në të gjitha vendimet gjyqësore deri sa të marrë formë të prerë nuk e fiton këtë të drejtë të pretenduar? Duhet të shihet ky moment në raport me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, ndërsa më çështjen tjetër që ka të bëjë me marrëdhëniet midis bashkëshortëve, në rastet kur kërkohet një zgjidhje martesë, këto janë probleme që gjykata vendos, pra përveç zgjidhjes së martesës ajo vendos për masën e pensionit ushqimor, se çfarë do të bëjë me banesën bashkëshortore deri në pjesëtimin e saj. Pastaj është pjesëtimi i pasurisë ai që e ndan përfundimisht këtë gjë. Këtu mund të bëjë sens dhe është pak më e pastër situata, në kuptimin se këtu mund të qëndrojë propozimi që është paraqitur dhe deri në zgjidhjen përfundimtare, qoftë të martesës, të pensionit ushqimor, të pjesëtimin të pasurisë dhe të banesës bashkëshortore, mundet që masat provizore të vendosura kanë sens dhe i shërbejnë atij qëllimi që thatë ju, qoftë për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, qoftë ato të grave dhe kështu me radhë apo më saktë për ta thënë më mirë, për të mbrojtur të drejtat e bashkëshortit më të dobët, sepse ne nisemi ndonjëherë nga ideja që do të mbrojmë gratë, por ndonjëherë mund të jetë edhe e kundërta, sepse ka pasur raste të tilla në gjykimin e çështjeve.

Besoj se në këtë drejtim, me pak ndërhyrje në kuptimin e teknikës legislative edhe duke gjetur vendin e duhur të dispozitave, jam dakord në parim me ndryshimet që propozohen te Kodi i Procedurës Civile, por disa ditë kohë mund të ishin të nevojshme për të reflektuar dhe për t'i vënë gjërat në vendin e vet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zonja Bregu.

Majlinda Bregu - Faleminderit!

Ju falënderoj për diskutimet.

Besoj se nuk ka gjë më delikate sesa ndjenjat. Në rast se njerëzit ndihen të lënduar, të ofenduar, të fyer, të kërcënuar, duhet të jetë një motiv shumë i fuqishëm për t'iu dhënë mundësinë që e gjithë shoqëria, të paktën të mos punojë në kahun e kundërt dhe t'i mëshojë pjesës së lëndimit.

Fatmir Xhafaj – Sa mirë do të ishte. A mund ta përsërisni për kënaqësinë e politikanëve të parlamentit shqiptar?

Majlinda Bregu - Zoti Xhafaj më vjen shumë mirë që kjo seancë po i bën të gjithë të reflektojnë më thellë.

Fatmir Xhafaj - Mua jo, por ata të tjerët.

Majlinda Bregu - Jemi të gjithë mëkatarë në pjesën e cenimit të njeri-tjetrit.

Një sqarim për zotin Subashi, interesi në propozimin e dytë për masën e përkohshme i referohet mbrojtjes së mirëqenies dhe në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës.

Ky ka qenë qëllimi im kryesor, pa ndarë përgjegjësinë asnjërit prej prindërve, por duke i detyruar se ka një përgjegjësi të përbashkët edhe në rastet e ndarjes dhe të divorcit për t'iu përgjigjur interesit të fëmijës.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zonja Bregu!

Falënderoj kolegët për debatin.

Mbyllim këtu këtë diskutim. Ashtu siç e parashtruam edhe në hyrje të këtij debati në ditët në vijim, pasi të kemi bërë konsultën e nevojshme me institucionet përkatëse, grupet e interesit dhe ekspertët e fushës, do të dëshiroja që këtë proces ta drejtojë relatorja, por do të ishte e dobishme që edhe vetë propozuesja, zonja Bregu të jetë e përfshirë, në mënyrë që të na mundësojë një zgjidhje, e cila të jetë sa më realiste dhe sa më ligjore.

Zonja Bregu është e hapur për këtë gjë, për të parë zgjidhjen më të mirë në funksion të realizimit të idesë shumë pozitive të parashtruar prej koleges.

Faleminderit, zonja Bregu!

Ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 01.04.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Dekretet e Presidentit nr. 8897, nr.8898, datë 16.01.2015 “Për emërimin e dy anëtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini dhe Nard Ndoka. Merr pjesë në këtë mbledhje edhe deputetja Majlinda Bregu.

Mungojnë: Oerd Bylykbashi, Tom Doshi

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Fjalën e ka zoti Subashi me çështjen që mbartëm nga dita e djeshme për dekretet. Relacionin e kanë kolegët. Prandaj mund të bëni vetëm një përmbledhje.

Armando Subashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Relacioni është shpërndarë që dje. Është një situatë e përsëritur që ndodh për të disatën herë, jo vetëm në komisionin tonë, por edhe në Kuvend për një marrëdhënie ligjore, kushtetuese midis dy institucioneve shumë të rëndësishme, midis Presidentit dhe Kuvendit, në rastin e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi nëpërmjet votimit të vet është shprehur disa herë nëpërmjet dokumenteve parlamentare që ka miratuar lidhur me mënyrën sesi duhet të respektohet ky raport ligjor midis Presidentit dhe Kuvendit. Për fat të keq edhe në këtë rast, me gjithë qëndrimet e mbajtura në mënyrë konsekuente dhe të vazhdueshme nga Kuvendi për këtë problem edhe kësaj radhe Presidenti i Republikës përsëri nuk respektoi detyrimin ligjor të parashikuar nga ligji, por të ezauruar edhe nëpërmjet dokumenteve parlamentare të Kuvendit.

Në fakt, ky rast që kemi përpara është dyfish i rëndë, sepse e gjithë procedura e emërimit të tyre është bërë në kushtet kur ishin miratuar ndryshimet në ligjin “Për Gjykatën e Lartë”, ku edhe ajo është një çështje tashmë e bërë publike dhe e diskutuar, ku të gjithë ne kishim vendosur, për t’i prerë rrugën këtij konflikti mes Presidentit dhe parlamentit. Ne vendosëm të bëjmë disa shtesa në ligjin “Për Gjykatën e Lartë”, duke krijuar një Këshill Konsultativ pranë Presidentit të Republikës, duke shtuar edhe disa kritere për ta bërë më transparente të gjithë procedurën e emërimit, por për fat të keq edhe pse ligji ishte miratuar, Presidenti vazhdoi të nxirrte këto dy dekrete, pra në momentin kur ishte miratuar ligji dhe priste të vihej në funksionim.

Mendoj se e gjithë kjo është një situatë tashmë e njohur për ne. Në relacion janë dhënë në mënyrë të përsëritur edhe kësaj radhe e gjithë jurisprudenca që ka ezauruar me vendimet e veta Gjykata Kushtetuese edhe interpretimi që i ka bërë ligjit “Për Gjykatën e Lartë”, edhe interpretimi që i ka bërë mënyrës së bashkëpunimit midis Presidentit të Republikës dhe kryetarëve të grupeve parlamentare përpara dekretimit të gjyqtarëve, por për fat të keq, siç e thashë kësaj radhe situata është thelluar akoma dhe më shumë në sensin negativ, jo vetëm nuk ka pasur një konsultim real ndërmjet Presidentit dhe kryetarëve të grupeve, përkundrazi në korrespondencën që ata kanë pasur midis kryetarëve të grupeve të Partisë Socialiste, LSI-së

dhe Partisë Demokratike, në fakt, është evidentuar me forcë ky moment dhe respektimi i ligjit që duhet të bëhet nga ana e Presidentit.

Ashtu siç kemi vepruar edhe herët e tjera, për shkak të moszbatimit të ligjit nga ana e Presidentit, për shkak të mos konsultimit me kryetarët e grupeve parlamentare përpara nxjerrjes së dekretit për dy anëtarët e Gjykatës së Lartë, do të ftoja kolegët të mbajmë të njëjtin qëndrim siç e kemi mbajtur edhe herët e tjera, me shpresën se ndoshta ky është qëndrimi i fundit që do të mbajmë në këtë mënyrë, pasi besojmë se tashmë ndryshimet që i janë bërë ligjit “Për Gjykatën e Lartë” dhe kanë hyrë në fuqi, edhe pas kthimit që i bëri Presidenti i Republikës do ta zhbllokojnë këtë situatë dhe do ta zgjidhin këtë problem, por jo vetëm kaq, ne besojmë se nëpërmjet shqyrtimit në mënyrë transparente të kandidaturave përmes marrjes së mendimit nga Këshilli Konsultativ që është ngritur pranë Presidentit të Republikës, dekretet e ardhshme do të jenë dekrete më të hapura, më transparente dhe padyshim që edhe kandidatët, të cilët do të vijnë përmes tyre, do të jenë kandidatët më të mirë, që do të përmbushin të gjithë pritshmëritë që kemi ne, opinionin publik ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Për ta mbyllur, do t’ju ftoja që ne t’i rrëzojmë këto dekrete pikërisht me këtë arsytim që thashë. Në seancën e djeshme, siç rezultoi, por edhe në të gjitha seancat e tjera, përgjithësisht nuk jemi marrë me cilësitë, me meritën, me përmbushjen e kriterëve shtesë, kriteret objektive, ligjore nga ana e kandidatëve, sepse kemi çmuar që për sa kohë nuk është zbatuar ligji në një moment shumë të rëndësishëm procedural, nuk ka vend që ne të thellohem në hetimin tonë dhe në vlerësimin e kandidatëve.

Prandaj për këto arsye që thashë, do të ftoja kolegët të vendosim rrëzimin e dekretëve të Presidentit dhe këtë gjë t’ia propozojmë seancës plenare në momentin e votimit të tyre.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Subashi!

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Faleminderit!

Në fakt, qëndrimi i maxhorancës është koherent, është një qëndrim i hapur politik që synon dhe ka vetëm një qëllim: kapjen e sistemit të drejtësisë në të gjithë proceset, gjatë gjithë këtyre 18 muajve. Dje, dëgjuam në seancën dëgjimore dy gjyqtarë model të këtij sistemi, me cilësitë më të mira që mund të kenë ata gjyqtarë në të gjithë armatën me 400 gjyqtarë. Ka probleme sistemi i drejtësisë. Ka gjyqtarë, të cilët janë përfolur për korrupsion. Ka gjyqtarë, të cilët janë deviantë, por e dimë se ka edhe gjyqtarë të ndershëm, që e nisin punën në mëngjes dhe e mbyllin në mbrëmje, me filozofinë e shërbimit të drejtësisë.

Dje, dëgjuam dy gjyqtarë që me sa e njoh unë, personalisht, sistemin e drejtësisë, janë gjyqtarë model të ndershmërisë, profesionalizimit, përkushtimit, paanësisë politike dhe karrierës në sistemin e drejtësisë.

Çfarë duam ne, si anëtarë të Komisionit të Ligjeve më shumë se kaq, nga ata që do të jenë nesër, gjyqtarë në Gjykatën e Lartë? Teorikisht, asgjë. Politikisht, shumë. Duam ta kapim, ta kemi për vete. Nuk na duhen gjyqtarët e ndershëm, të cilët janë të përkushtuar. E kam thënë dhe më parë, siç u tha tani, se vota kundër gjyqtarëve të ndershëm, është votë pro gjyqtarëve të korruptuar, është votë që dekurajon gjyqtarët e ndershëm të këtij sistemi. Mos guxoni të vini këtu, pa bërë marrëveshje me ne, me palën politike! Çfarë ndodh?

Ka histori ky komision, ku edhe ne për të qenë të sinqertë, kemi rrëzuar kandidaturat e ardhura nga Presidenti, por ua kemi bërë të qartë qytetarëve shqiptarë, se ato kandidatura që ka sjellë Presidenti, jo se nuk na pëlqenin në politikisht, se ai nuk është marrë vesh me kryetarin e grupit tonë parlamentar, por i kemi rrëzuar se ato kanë pasur probleme të merita të tyre, pra, nuk kanë qenë në kontingjentin e gjyqtarëve të ndershëm dhe të përkushtuar të këtij sistemi. Askush nga ju, nuk na ka kundërshtuar dhe nuk na ka thënë se ky kandidat nuk e kishte këtë të metë, që kemi propozuar ne.

Gjithsesi, edhe argumenti që ju sillni se ju kështu e keni bërë dhe ne do t'ju bëjmë më keq, argumenti i hakmarrjes, është po aq vrastar për sistemin e drejtësisë.

Po jua them edhe një herë: Ju që thoni për të disatën herë për dekretet e Presidentit, se gjyqtarët që vijnë këtu nuk kanë asnjë të metë, janë gjyqtarë të ndershëm, kanë merita, janë të përkushtuar, por nuk na pëlqejnë, sepse Presidenti nuk është ulur me kryetarin e grupit tonë parlamentar, apo me Kryeministrin, për të zgjedhur emrat, për ne, është votë kundër gjyqtarëve të ndershëm dhe është votë pro gjyqtarëve deviantë. Nuk bëhesh dot anëtar i Gjykatës së lartë nëse je gjyqtar i ndershëm, për të ardhur pastaj te pjesa e ligjit “Për Gjykatën e Lartë”, të cilin ju e bëtë në mënyrë të njëanshme, pa konsultimin e Komisionit të Venecias, të cilët ranë dakord në tetor të vitit të shkuar, dhe e bëtë vetëm e vetëm, për të kapur Gjykatën e Lartë.

Ju bëtë një ligj ku do të ndërtohet një komision me prezencën qeveritare të ministrit të Drejtësisë, i cili do t'i propozojë Presidentit kandidatët.

Më thoni mua, se ç'punë ka ministri i Drejtësisë, t'i propozojë Presidentit anëtarët e Gjykatës së Lartë?

Më thoni një model, ku ministri i kabinetit qeveritar, të jetë prezent në komisionin, i cili do t'i propozojë Presidentit emërimet!

Sot, nuk që në komision ministri dhe na erdhën dy gjyqtarë të ndershëm, të cilët po i rrëzojmë pa ndonjë argument, vetëm me argumentin politik. Na duhet komisioni që do të

propozojë ministri, në mënyrë që kandidatët të jenë të vlefshëm. Na duhet që kandidatët që do të vijnë, duhet ta zgjidhin me ministrin (kushdo qoftë ai), ndryshe sot do t'i rrëzojmë dhe me të njëjtën linjë, siç vepruat për ligjin e KLD-së. Bëtë gjithë atë zhurmë për anëtarët e KLD-së, sepse do ta ndryshonit KLD-në. Bëtë një ligj për KLD-në, i cili solli një efekt. Çfarë efektesh solli ai për KLD-në, siç do të sjellë edhe ky?

Ai ligj solli vetëm një efekt: atë të zëvendësimit të karrigeve. Hoqëm 3 anëtarë dhe sollëm 3 militantë të PS-së. Zëvendësministrin e Drejtësisë e bëtë anëtar të KLD-së.

Si mund t'u thotë qytetarëve ai: “Mirë, unë isha ministër, por tani jam i pavarur. Isha ministër, por e hoqa xhakëtën e politikanit dhe u bëra i pavarur. Duhet të më besoni!”

Morët avokatin e PS-së, gjyqtarin e diktaturës dhe e bëtë anëtar të KLD-së, se na u bë i pavarur. Si na u bëka i pavarur ky avokati i PS-së?

Sollët edhe një militante të PS-së, e cila ishte kamikaze e saj dhe e bëtë anëtare të KLD-së.

Ky është rezultati, kështu e shihni ju. Bëtë ligjin për KLD-në dhe rezultati ishte zëvendësimi i karrigeve, duke mos sjellë 3 ekspertë të ligjit, të pavarur nga politika, por sollët 3 militantë politikë.

Të njëjtën gjë po bëni edhe me Gjykatën e Lartë.

Njerëzit pyesin: “Përse duhet Gjykata e Lartë?”

Tani në Gjykatën e Lartë ka disa procese prandaj na duhen ata njerëzit tanë dhe jo gjyqtarët e ndershëm dhe të gjithë të tjerët që kanë qenë më parë. Deputetë të tjerë këtu, bile edhe deputetë të LSI-së kanë thënë: këta gjyqtarë janë të ndershëm, por nuk na duhen. Na duhet ta lidhim patjetër me politikën.

Prandaj bëhet kjo, për të dekurajuar gjyqtarët e ndershëm dhe për t'u thënë: “Po nuk e zgjidhët me ne, po nuk zgjidhët ngërçin që kemi ne si maxhorancë me Presidentin, ju nuk bëheni anëtarë të Gjykatës së Lartë. Le të jeni të ndershëm, të përkushtuar, le të keni meritë, ju nuk puthni në Gjykatën e Lartë”.

E dyta, sepse Gjykata e Lartë na duhet, se ajo ka disa procese dhe do të vazhdojë të ketë. Të gjithë e dimë. Ndaj s'na duhen gjyqtarët e ndershëm, por na duhen gjyqtarë deviantë dhe politikë, që të na mbrojnë krahët nesër, kur të shkojmë atje.

Ndaj po ju them edhe një herë: mos votoni kundër gjyqtarëve të ndershëm, kushdo qofshin ata, se vota kundër tyre, është votë pro gjyqtarëve të korruptuar dhe deviantë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Unë, megjithëse ndryshe nga të tjerët, kam qenë në konsultimet me Presidentin e Republikës, ndaj të njëjtat mendime me kolegun parafolës, që me të vërtetë ka pasur koherencë, sepse në mënyrë shumë koherente i është thënë Presidentit qartë dhe saktë, pa ngarkesa politike, që duhet patjetër të ndërtojmë një proces. Jashtë procesit, çdo kandidaturë tjetër, është pjesë e interpretimit: kur e zgjedhim ne është llagar ose i pastër, siç i thonë nga zona jonë dhe kur e zgjedhin të tjerët, ky do të jetë o deviant, o i korruptuar, megjithëse vazhdon të jetë pjesë e sistemit. Besoj se këtu çoroditja logjike bëhet shumë më e fortë, sepse ata gjyqtarë që janë pjesë e sistemit janë në një sistem vlerësimi të caktuar dhe në qofshin deviantë apo në qofshin të korruptuar, ai sistem i pavarur ka mundësi t'i verifikojë dhe t'u vërë edhe notën dhe të mos i mbajë më në sistem, por sa kohë që janë pjesë në atë sistem, kanë të drejtë të aplikojnë dhe të zgjidhen, sipas procedurave përkatëse.

Cilat kanë qenë arsyet që e kemi kërkuar procesin?

Procesi sa më i plotë dhe sa më transparent i largon argumentet politike të radhës, sepse ne dhe të gjithë shqiptarët e dimë shumë mirë, që për vite me radhë procesi i rifreskimit të Gjykatës së Lartë ka ndodhur dhe çdo votë që maxhoranca jep, konsiderohet kapje e sistemit dhe do të thotë që çdo maxhorancë, kur voton një kandidat, kapka sistemin.

Me këtë logjikë të thjeshtë se as ne, si të gjithë shqiptarët s'jemi fëmijë dhe nivelin e argumentit duhet ta ngremë, sepse s'mund të biem në diskutime të tilla foshnjarake, do të thotë se ata të zgjedhur për vite të tëra me radhë, të një maxhorance tjetër, paskan qenë të kapur.

A do t'i imponohemi njëri-tjetrit me zor?

Absolutisht nuk e imponojmë dot njëri-tjetrin me zor dhe arsyetimet tona nuk i dëgjojnë dot të tjerët, por shqiptarët e kuptojnë fare mirë që nëse kjo qenka kapje e maxhorancave, ky sistem qenka i kapur dhe legjislacioni i propozuar për ndryshimet në ligjin përkatës për të krijuar një Këshill Legjislacioni, ku përfaqësuesit (është mirë ta dinë shqiptarët, sepse boll dëgjuan të pavërteta), shumica e atij komisioni nuk janë të ministrit të Drejtësisë, s'kanë lidhje fare me të, por janë anëtarë të institucioneve kushtetuese, që janë zgjedhur dhe gëzojnë besimin e drejtpërdrejtë të Presidentit të Republikës.

Komisioni ishte një mekanizëm lehtësues dhe ekuilibruës, për të cilin është diskutuar gjatë edhe me Presidentin e Republikës për të krijuar një mekanizëm transparent dhe gjithëpërfshirës për institucionet më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë. Këto gjëra janë të njohura për publikun, por ne po detyrohemi t'i themi për të dhjetën dhe për të njëzetën herë, sepse historia e kapjes dhe rrahjet e gjoksit që disa i duan dhe këputen në mes për gjyqtarët e ndershëm, kurse ne jemi avokatët e gjykatësve të pandershëm, kjo është damka më e rëndë

që i hidhet sistemit, dhe jo neve, sepse e përsëris, meqë kemi edhe mediet këtu: sistemi ka një sistem vlerësimi dhe në rast se jemi të ndërgjegjshëm, që brenda sistemit qenkan të korruptuar e deviantë, të cilët nuk dalin nga sistemi, megjithëse ka një mekanizëm vlerësues për secilin, dhe secili ka ardhur nga një konkurrim me një sistem vlerësimi, atëherë, do të thotë që ai që e bëra këtë vlerësim, paska përgjegjësi shumë të rënda dhe këto përgjegjësi nuk shkojnë te ky komision, as te kjo maxhorancë, por shkojnë te një institucion tjetër.

Meqenëse jemi në një qëndrim të motivuar dhe koherent, edhe arsyt e këtij votimi për të cilin po e deklarojmë votën, kanë të bëjnë me ndërtimin e një mekanizmi dhe nuk kanë të bëjnë me demagogjinë e personave të përshtatshëm apo jo të përshtatshëm, sepse siç u tha këtu me të vetmin moment sinqeriteti, janë rrëzuar kandidatura shumë të përshtatshme, edhe më të mira se këto. Kjo është fare e vërtetë. Nëse të tjerët duan të harrojnë, ne nuk harrojmë. Sistemi dhe mekanizmi na mbron dhe nuk na mbrojnë fjalët.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Meqenëse zoti Halimi i përmendi disa me identikit, unë do t'i përmend me emra.

Zoti Halimi foli për ligjin e KLD-së dhe na akuzoi se vumë një zëvendësministër. Ju kujtoj se këta vunë një ish-prokuror dhe një ish- zëvendësministër, anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Mbi çfarë kriteri e bënë?

Po flas për vlera morale.

Heshtni, të paktën!

Ne (po i them me emra ata të dy, që përmendët ju), që t'i dëgjojnë gjyqtarët. Po i them me emra, sepse sot vër kë të duash dhe votoje në komunitetin e gjyqtarëve dhe nëse votohet sot për Sokol Çomon, ju them se nuk ka gjyqtar në republikë, që i mohon Sokol Çomos dy cilësi: ndershmërinë dhe profesionalizmin. Është nder, që ajo trupë gjyqësore e ka anëtar të KLD-së dhe nuk është mëkat se ka qenë zëvendësministër në qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Mëkat është të jesh i paafte dhe i pandershëm, gjë që ai njeri jo vetëm që nuk i ka, por sot është simbol në drejtësi për këto dy cilësi dhe këtë e thonë edhe gjyqtarët që i keni vendosur ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ju përmendët Vangjel Kostën, pedagogun tuaj, zoti Halimi, një nga gjyqtarët më të mirë që ka ky vend, nga gjyqtarët më të ndershëm që ka pasur Gjykata e Lartë në historinë e saj, një nga ekspertët më të mirë në fushën e të drejtës civile. Ai jo vetëm që nuk ka qenë avokat i PS-së...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Nëse e ka pajtuar, shumë mirë ka bërë PS-ja. Ajo do të marrë avokat.

Po ju them se zotin Kosta nuk e njihnin 90% e grupit të PS-së, kur u propozua dhe kjo i bën nder Grupit Parlamentar të PS-së, se nuk zgjodhi njeri që e njihnin korridoret e PS-së, por zgjodhi një nga ekspertët më të mirë të këtij vendi dhe kjo i bën nder kësaj maxhorance, përballë atyre që kishit vënë ju.

A e dini se kë kishit vënë ju? Ata që kishin kontribuar në shkatërrimin dhe vjedhjen e pronave të shqiptarëve, në interesin tuaj. Ata kishit vënë ju dhe ne propozuam ish-gjyqtarë dhe ekspertë nga më të mirët në sistemin e drejtësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ju lutem, ju thatë që duam të kapim Gjykatën e Lartë.

Zoti Halimi, a nuk keni qenë ju dhe kolegët tuaj që keni thënë, se aty kanë shkuar gjyqtarët që kanë paguar?

Gjyqtarët që janë aty sot, ju i keni akuzuar publikisht në këtë sallë, në këtë parlament se kanë paguar te ish-Presidenti i Republikës dhe ish-zëvendëskryetari i KLD-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po jua them edhe këtë: i keni rrëzuar herën e parë dhe i keni votuar herën e dytë, gjë që më bën të mendoj se herën e parë nuk kanë paguar dhe kanë paguar herën e dytë. Unë nuk besoj fare te kjo teori, por ky është fakt. Nëse mund të kapet, nuk mund të kapet gjyqësori në këtë mënyrë, por kapet pikërisht në këtë mënyrë. Nëse kanë paguar, ata janë robër të korrupsionit.

Ajo që duhet të bënit por nuk e bëtë është: nëse kishit indicie të tilla, duhet t'i kishit çuar në prokurori dhe të mos linit baltë mbi anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe mbi gjyqësorin.

Sa i takon ministrin të Drejtësisë, të them të drejtën është e drejta juaj, këndvështrimi juaj, unë s'e di sesi në 7 veta që do të gjykojnë, njëri është ministri i Drejtësisë, që e prishka këtë raport në këshill. Meqenëse është retorikë e njohur në gjithë botën, ju them se ju them se ministrat e Drejtësisë në disa vende europiane anëtare të BE-së, propozojnë dhe emërojnë gjyqtarë.

Një ministër i Drejtësisë, në një grup prej 7 vetash, deformoka qëndrimin parimor të propozimit! Kjo është absurde. Unë e kuptoj shumë mirë, që ju doni të bëni politikë, por të paktën bëni politikë mbi disa të vërteta dhe mbi disa parime koherente të qëndrimeve tuaja dhe kjo do të ishte normale, nëse nuk do të kishit demonstruar një qasje krejt tjetër gjatë kohës që keni qenë në pushtet.

Ju thatë që keni rrëzuar kandidatura me probleme. Është turp në histori e këtij vendi, jo vetëm tuajën. Ju keni rrëzuar kandidaturën e Kristaq Trajës. Po jua them, që ta dëgjoni mirë: Kristaq Traja është ish-gjyqtar i Gjykatës së Strasburgut, i pari gjyqtar i dominuar nga

Shqipëria në këtë gjykatë. Mbasi gjykoi çështje në Gjykatën e Strasburgut, erdhi në Shqipëri dhe u gjend i padenjë, për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe po them jo vetëm se ka qenë gjyqtar i Gjykatës së Strasburgut, por është mendimi i të gjithë ekspertëve, që ai është një nga juristët më të mirë të këtij vendi. Atë keni rrëzuar ju! Për çfarë e keni rrëzuar? Ka qenë i paaftë apo i pazoti? Jo, e keni refuzuar se nuk ka qenë besniku juaj dhe nuk ka vajtur të puthi dorën e padronit, para se të emërohej në gjykatë. Ka bërë mirë që s'e ka bërë këtë gjë se ka mbetur i ndershëm, si gjyqtar dhe nuk do të ishte si ata që janë të varur në moral dhe në bindje. Ju thatë se gjyqtarët që janë këtu s'kanë asnjë të metë. Unë mendoj se jo të gjithë ata që kanë ardhur këtu, kanë qenë gjyqtarë pa të meta. Përkundrazi.

Po ju them një gjë për të cilën jam i bindur: nuk mund të shkojë kushdo në Gjykatën e Lartë. Ajo gjykatë nuk është stacioni i radhës, që po hipe në trenin e gjyqësorit, do të ndalosh patjetër aty. Jo, Gjykata e Lartë është rezultat i një sistemi karriere, por edhe i disa cilësive të veçanta, sepse është Gjykata e Lartë e vendit që bën politikën në gjyqësor, që ka vendimmarrjen finale në gjyqësor, që bën identifikimin e praktikës gjyqësore dhe hap shtratin për unifikimin, për qëndrimin që duhet të mbajnë gjykatat në Shqipëri dhe presumohet, që aty të jenë gjyqtarët më të përgatitur të këtij vendi, ata që kanë lexuar dhe vazhdojnë të lexojnë.

Gjyqtarë që deklarojnë këtu se nuk kanë kohë të lexojnë dhe duhet të shkojnë në Gjykatën e Lartë, vetëm në këtë republikë mund të ndodhi të bëhen anëtarë të Gjykatës së Lartë. Kjo është e papranueshme. Unë nuk do ta votoja kurrë një gjyqtar të tillë. Ai mund të jetë gjyqtar i ndershëm, mund të ketë 30 vjet karrierë si gjyqtar dhe unë me gjithë respektin jam dakord të marrë maksimumin e vlerësimit për atë pozicion që ka, në Gjykatën e Shkallës së Parë apo në Apel, por nuk do t'ia jepja vlerësimin për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë, një ndër 7 anëtarët Gjykatës së Lartë të vendit tim, që do të vendosë dhe do të unifikojë praktikën dhe do t'i hapë shtratin e vendimmarrjes të gjitha gjykatave të vendit.

Ju do të më pyesni: përse nuk e keni thënë këtë?

Ka një shprehje të urtë popullore: “Ka 100 arsye pse nuk bien kambanat. E para, nuk ka kambanë dhe 99 arsyt e tjera nuk kanë vlerë”.

Arsyeja që nuk vazhduam me 99 të tjerat, ishte se kambana që duhet të binte e që mungonte ishte kambana e Presidentit të Republikës, për arsye se atë kambanë e kishit mbushur me kashtë, që të mos dëgjohej.

Eduard Halimi – Meqë ma përmendët 6 herë emrin, po flas edhe unë 3 minuta.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

E para, për pjesën e Gjykatës Kushtetuese kjo parti nuk mund të krenohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Do të flas edhe unë, se ma përmendi disa herë emrin.

Lidhur me Gjykatën Kushtetuese ka disa deputetë që s'mund të flasin, sepse nëse ka pasur deri në vitin 2005 një politizim tejet të skajshëm të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë, ajo ka ndodhur gjatë 8 vjetve të qeverisjes së Partisë Socialiste.

Kryetari i Komisionit të Ligjeve, u bë kryetar i Gjykatës Kushtetuese (mendonin zotin Xhafaj).

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Nuk shkon, se je politik. Nëse thua se ne kështu e çlirojmë gjyqësorin nga politizimi, atëherë po bën budallenj 99% të shqiptarëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ministrin e Drejtësisë e bëtë kryetar të Gjykatës së Lartë. Më thoni, për një demokraci të brishtë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir, nuk ju ndërpreva. Më lër të flas 3 minuta, se do të iki se kam mbledhje.

Është e vërtetë që në qeverisjen tuaj u vu kryetar i Gjykatës së Lartë ish-ministri i Drejtësisë dhe kryetar i Gjykatës Kushtetuese u vu ish-kryetari i Komisionit të Ligjeve. Deputetë të PS-së, i vutë anëtarë të Gjykatës së Lartë. 3 deputetë të tjerë të PS-së, i vutë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Ne nuk ecim me frymën e hakmarrjes dhe të themi: meqë ju e kishit bërë kështu, hajde t'ua bëjmë edhe më keq, sepse fryma e hakmarrjes është filozofia më e keqe, që mbizotëron në politikë. Nëse do të ecnim me të njëjtën filozofi, siç ecni ju tani: "Meqë ju na keni rrëzuar njërin, që na qenka heroi i drejtësisë, ne do t'ju rrëzojmë të gjithë të tjerët". Kjo është frymë e hakmarrjes dhe jeni tërësisht të gabuar në këtë histori.

Lidhur me çështjen e pagimit të dekreteve, kjo e dhënë nuk ka dalë nga PD-ja, por ka dalë nga progres-raportet e BE-së, ku ka rezultuar se gjyqtarët paguanin të ish-Presidenti, të cilin e keni marrë në prehër dhe e keni mbushur me kashtë dhe me pambuk, së bashku me kryetarin tuaj. Kjo e dhënë ka dalë nga raportet e BE-së.

Çfarë bëmë ne në atë kohë?

Presidenti ishte yni. Mund të bënim të njëjtën gjë, që bëni edhe ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ne u vumë kufirin te thana të gjithë atyre kandidatëve, të cilët erdhën nga Presidenti dhe kishte dyshime (dhe ju e dini), kishte kandidatë, që të gjithë i njohim shumë mirë, të cilët i kishin harruar 200 mijë eurot, sepse ua kishte paguar vëllai që punonte emigrant në Kanada

apo kishte kandidatë që kishin punuar 4-5 vjet, si avokatë dhe s'kishin paguar asnjë ditë tatime.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

E mbani mend që kishte kandidatë që thoshin se s'i mbanin mend 200 mijë eurot, se ua kishte paguar vëllai që punonte në Kanada?

Këtyre u vumë kufirin dhe kjo është situata. Nuk duhet të vazhdoni më me këtë histori, sepse vota kundër gjyqtarëve të ndershëm, është votë pro gjyqtarëve të korruptuar dhe deviantë.

Ata po inkurajoni, duke dekurajuar gjyqtarët e ndershëm. Kur do të dalin? Ky është një proces që vazhdon. Nuk e kemi mbyllur dot ne dhe nuk do ta mbyllin dot këta, se do të vazhdojë. Procesi i largimit të gjyqtarëve deviantë vazhdon. Kemi vazhduar ne, do të vazhdoni ju, do të vazhdojmë përsëri ne. Nuk zgjidhet aq thjesht, por ama, meqenëse ne kemi mbledhje grupi, votën tonë e deklarojmë pro. Në qoftë se do të vazhdohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, e caktojmë dhe vazhdojmë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush është pro dekreteve? Kush është për rrëzimin e dekreteve? Dhjetë vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Sa jemi? 14 me 2.

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 01.04.2015, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Raporti vjetor i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini dhe Nard Ndoka. Merr pjesë në këtë mbledhje edhe deputetja Majlinda Bregu.

Mungojnë: Oerd Bylykbashi, Tom Doshi

Të ftuar:

Besnik Dervishi - komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Pjerina Gaxha- drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Ardita Shehaj - drejtore e Drejtorisë së të Drejtës për Informim

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Në këtë mbledhje komisioni kemi dy pika të rendit të ditës, dy raportimet e institucioneve, fillimisht të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe pastaj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Zoti Besnik Dervishi, jeni i lutur të zini vend!

Faleminderit!

Besnik Dervishi – Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Garantimi i të drejtave kushtetuese, e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale, përbëjnë misionin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Gjatë vitit 2014 veprimtaria e institucionit është përqendruar fillimisht vetëm në pjesën e mbrojtjes së të dhënave dhe më pas me shtyllën tjetër të rëndësishme, me të drejtën e informimit.

Progresi i nisur dhe i intensifikuar në muajt e fundit është paraprirë nga ligjet bazë që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni, rekomandimet e Kuvendit, si dhe progresraporti i Bashkimit Europian.

Në aktivitetin e punës, Zyra e Komisionerit ka pasur prioritet të saj parandalimin dhe shmangien e rasteve të përpunimit të kundërligjshëm të të dhënave personale.

Forcimi i zbatimit të ligjit është konsideruar i lidhur ngushtë me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit nënligjor, si dhe me rolin aktiv për t’i ofruar asistencë ligjore subjekteve të ndryshme publik dhe privatë. Ky raportim identifikon ndërmarrjet e iniciativave të reja lidhur me përmirësimin e teknikave të hetimit administrativ, të pasqyruara kryesisht në muajt e fundit të vitit kalendarik 2014, si pasojë e të cilave është rritur ndjeshëm numri i inspektimeve.

Tërësia e procesit të hetimit administrativ është zhvillimi i ankesave, por edhe hetime administrative të ndërmarra kryesisht nga Zyra e Komisionerit.

Miratimi i ligjit nr.119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” përbën një moment tjetër për t’u vlerësuar në veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit.

Në muajin nëntor, Zyrës së Komisionerit iu atribuuan kompetencat e parashikuara në këtë ligj, duke i dhënë një fizionomi tjetër institucionit. Në monitorimin e zbatimit të ligjit u synua ndërgjegjësimi i autoriteteve publike dhe shoqërisë në tërësi, trajtimi i ankesave të individëve në afat, përgatitja e programit model të transparencës e të tjera detyrime që burojnë nga ky ligj.

Duke filluar nga nëntori deri në fund të muajit dhjetor, pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar 26 ankesa nga persona fizikë dhe juridikë lidhur me mosrespektimin dhe garantimin e së drejtës për informim. Nga këto ankesa, katër janë deleguar nga institucioni i Avokatit të Popullit. Ndërkohë, nga numri total i ankesave për pesë raste është kryer inspektim në vend, për tri raste të tjera janë zhvilluar seanca dëgjimore, ndërsa janë dhënë dy vendime për urdhërim të autoriteteve për dhënie informacioni të kërkuar.

Nga çështjet e shqyrtuara Zyra e Komisionerit konstaton se ligji “Për të drejtën e informimit” nuk është zbatuar në nivelin e kërkuar nga administrata publike qendrore dhe vendore, duke shmangur kështu detyrimet e tyre për dhënien e informacionit të kërkuar.

Autoritetet publike nuk kanë caktuar ende koordinatorin. Detyrimi i parashikuar në ligj thotë se “Komisioneri, në çdo rast të komunikimit shkresor, por edhe në aktivitete të zhvilluara për këtë qëllim, ka kërkuar përmbushjen e këtij detyrimi ligjor”. Në përmbushje të detyrimeve ligjore u hartua dhe u miratua me urdhër të Komisionerit programi model i transparencës për autoritetet publike, dokument tashmë i publikuar në faqen zyrtare të institucionit, por edhe në Fletoren Zyrtare nr. 6 të datës 28 janar 2015.

Natyrisht, gjatë kësaj periudhe janë hasur edhe disa problematika në lidhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve të para për të drejtën e informimit kemi evidentuar probleme që lidhen me përmbajtjen e dispozitave të ligjit, si dhe me zbatimin konkret të tyre.

Trajtimi i çështjes bëhet vetëm për të konstatuar ndjekjen e procedurave nga autoritetet publike për trajtimin e kërkesave apo duhet përcaktuar edhe shqyrtimi i ankesave në themel nga Komisioneri.

Kërkohet të përcaktohet kategoria e autoriteteve publike, pasi disa prej tyre, megjithëse ushtrojnë funksione publike, nuk përmbushin kriteret e tjera të përcaktuara në përmbajtje të përkufizimit që parashikon ligji.

I njëjti përcaktim duhet bërë edhe për kategorinë e sistemit gjyqësor, pasi ankesat adresohen edhe për pajisje me vendime gjyqësore apo dosje gjyqësore të palëve ndërgjyqëse, ndërsa do të duhet të jepet një përgjigje nga autoriteti dhe sistemi gjyqësor, ku konkurron vijueshmëria e procesit gjyqësor në përputhje me legjislacionin civil, penal apo atë administrativ.

Në analizat e afatit 15 ditë punë për shqyrtimin e ankesës në raste të veçanta, në ndonjë rast mund të rezultojë edhe e pamjaftueshme, ku për disa veprime, siç është rasti i kërimit të parashtrimeve apo zhvillimit të seancave dëgjimore, lind nevoja për t’iu referuar afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative apo edhe në ligjin nr.10279 “Për

kundërvajtjet administrative”, ashtu siç vazhdon të mbetet, por besoj se me mbështetjen tuaj do të realizohet në vijim, edhe forcimi i strukturës përkatëse, si dhe ambientet e punës.

Në mbrojtjen e të dhënave personale gjatë kësaj periudhe, pranë Zyrës së Komisionerit ka vijuar procesi i njoftimit të subjekteve, ku kanë njoftuar 728 kontrollues. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përfundimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës deri në fund të vitit 2014 ka arritur në 4707. Në krahasim me vitin e mëparshëm, në vitin 2014 janë kryer 146 deklarime më shumë, ndërsa numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara për këtë periudhë është 802, duke e çuar numrin e subjekteve të regjistruar në 4665 me 135 regjistrime më shumë.

Përgjatë vitit 2014 nga Zyra e Komisionerit janë kryer 67 kontrolle administrative me objekt të përgjithshëm, në zbatim të ligjit nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe akteve nënligjore nga ana e kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit ka ushtruar inspekte në terren dhe *online*. Inspektimet *online* janë fokusuar në përpunimin e të dhënave personale në faqen në internet të kontrolluesve për politikën e privatësisë, informimin e subjekteve të të dhënave personale, mënyrat e marrjes së pëlqimit të subjekteve të të dhënave, publikimin, ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave nga faqja në internet e kontrolluesit e të tjera. Për shkak të zhvillimeve teknologjike një pjesë e madhe e shërbimeve nga kontrolluesit publikë dhe privatë realizohen *online*.

Nga Zyra e Komisionerit janë zhvilluar 53 inspekte *online* në faqen në internet të kontrolluesve dhe për të gjithë këta kontrollues është dërguar fillimisht rekomandim. Kjo është bërë me qëllim krijimin e hapësirave ligjore që vetë kontrolluesit të rikuperojnë shkeljet dhe të garantojnë që veprimtaria e tyre të organizohet në përputhje me parimet e ligjit dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij. Për këto rekomandime është bërë verifikimi, më pas zbatimi i tyre, ku ka rezultuar se 15 kontrollues nuk kishin reflektuar sugjerimet e bëra në rekomandim dhe për tre prej tyre është proceduar edhe me sanksion administrativ “gjobë”.

Gjithashtu janë realizuar inspekte administrative në terren mbi bazë ankesash, verifikime të përmbushjes së rekomandimeve dhe urdhrave të Komisionerit, si dhe verifikim të përmbushjeve të detyrimeve të përcaktuara në ligj. Në total, numri i inspekteve në terren ka qenë 37, prej të cilave 27 kanë qenë me objekt verifikimi i zbatimit të rekomandimeve dhe urdhrave të Komisionerit.

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit është shprehur me 11 vendime për kontrollues të ndryshëm që inspektojnë me 19 sanksione administrative “gjobë”. Vendosja e sanksioneve administrative është realizuar nga Zyra e Komisionerit në mbështetje të ligjit, si dhe në respektim të parimeve të ligjshmërisë, të transparencës në vendimmarrje dhe të drejtës së

palëve për t'u dëgjuar. Për të gjitha raste,t përpara marrjes së vendimit përfundimtar, janë zhvilluar seanca dëgjimore me subjektet kontrolluese, një praktikë e re kjo e parealizuar deri tani.

Është vijuar me vënien në ekzekutim të vendimeve të gjobave të Zyrës së Komisionerit. Gjatë këtij viti janë marrë masa që të bëhet një rievidentim i të gjithë situatës në lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve të gjobave të vendosura përgjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.

Në mënyrë statistikore, situata e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve përpara vitit 2014 rezulton: gjithsej janë 27 sanksione administrative gjobë të vendosura, nga të cilat 3 vendime janë ankimuar në gjykatë dhe 2 janë revokuar.

Për sa më sipër, vendime që janë vënë në ekzekutim të detyrueshëm nga zyrat përmbartimore janë 52 që i korrespondojnë sanksioneve administrative me gjobë, nga të cilat, deri në vitin 2013 ishin ekzekutuar vetëm 30.

Gjatë vitit 2014 u vu në lëvizje edhe ekzekutimi i 22 vendimeve të tjera, pra që i përkasin periudhës deri në fund të vitit 2013, nga të cilat janë ekzekutuar 19, kurse 3 të tjera janë pezulluar për shkak se subjektet janë çregjistruar dhe nuk ekzistojnë më.

Gjithashtu, për sa u përket vendimeve me sanksion administrativ të vendosura gjatë vitit 2014, janë gjithsej 19 sanksione administrative me gjobë, nga të cilat janë ekzekutuar 14, dy janë në proces administrativ (pritet të plotësohet afati), ndërsa 3 të tjera janë në proces gjyqësor.

Vlen të theksohet se 3 procese gjyqësore, ku gjoba është ankimuar, janë fituar nga Zyra e Komisionerit.

Gjithashtu janë zhvilluar mjaft aktivitete. Është festuar 28 janari (Dita Europiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale), janë zhvilluar konkurse letrare dhe aktivitete të ndryshme me nxënësit e shkollave, në universitete. Është zhvilluar një seminar trajnues për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe me përfaqësues të administratës vendore. Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Shkollën shqiptare të Administratës Publike ka vazhduar trajnimin e thelluar me personat e ngarkuar të kontrolluesve publikë nëpërmjet moduleve të administruar prej tyre. Aktualisht identifikohen rreth 65 persona të certifikuar në këtë fushë.

Gjithashtu, është marrë pjesë në panairin e librit, ku është bërë promovimi i të gjitha akteve dhe fletëpalosjeve të Komisionerit, si dhe është zhvilluar një takim mjaft i rëndësishëm, seminar me ekspertë ndërkombëtarë, për implementimin e rregullave të detyrueshme të

korporatave në hapësirën frankofone, edhe kjo një risi të cilën ne po vazhdojmë ta aktivizojmë edhe këtë vit duke zhvilluar trajnime të rëndësishme me trajnues ndërkombëtarë.

Në aspektin legjislativ janë hartuar katër akte nënligjore, katër udhërrëfyes, është dhënë mendim për dhjetë projektligje dhe për nëntëmbëdhjetë projektakte nënligjore. Këtu vlen të theksohet që ende nuk zbatohet detyrimi nga institucionet propozuese të akteve normative për të kërkuar mendimin dhe vlerësimin e Komisionerit për përputhshmërinë e këtyre akteve me ligjin nr.9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” që, në fund të fundit, është detyrim që buron nga vetë ky ligj.

Gjithashtu, për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale janë shqyrtuar gjashtë praktika dhe janë dhënë katër vendime.

Risi tjetër është miratimi në datën 31 tetor të vitit 2014 nga Kuvendi i ligjit nr. 146 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Ligji ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent e gjithëpërfshirës lidhur me procedurën e vendimmarrjes së projektakteve me karakter normativ, dokumentet strategjike dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ligji ka parashikuar ankimimin pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në rast se palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik. Ligji hyn në fuqi në maj të vitit 2015 dhe ne jemi duke punuar paraprakisht, por kërkojmë mbështetjen për ndërtimin dhe forcimin e strukturës përkatëse, pasi edhe ky ligj është mjaft i rëndësishëm.

Zyra e Komisionerit është aktive dhe në marrëdhëniet ndërinstitucionale ku ne kemi kontakte mjaft të konsoliduara me Prokurorinë e Përgjithshme dhe një bashkëpunim shumë të frytshëm me Ministrinë e Drejtësisë, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit e së fundmi edhe me AMA-n, me AKEP-in.

Gjithashtu për ndërgjegjësimin e dhënies mendim të projektligjeve kemi zhvilluar me ndërmjetësimin e sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe një trajnim me sekretarët e Përgjithshëm të të gjitha ministrive.

Edhe në fushën ndërkombëtare vlen të theksohet që për këtë vit organizohen në Shqipëri dy takime mjaft të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe ky është një vlerësim mjaft i lartë për autoritetin shqiptar, pasi kjo nënkupton se vlerësohet dhe trajtohet njëloj me të gjithë homologët e tjerë dhe me shtetet e konsoliduara europiane.

Organizohet Konferenca e 17-të e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, si dhe në muajin shtator Autoriteti Shqiptar është

përzgjedhur për të zhvilluar takimin ndërkombëtar të autoriteteve europiane për trajtimin e rasteve të veçanta, tashmë me mbështetjen e autoritetit britanik.

Në stadin aktual, duke vlerësuar dinamikën e zhvillimit, objektivi kryesor, përveç sensibilizimit të kontrolluesve në të gjitha aspektet e tij, që nga njoftimi dhe deri te sanksioni, vlerësohet edhe rishikimi i ligjit për të plotësuar dhe për të transpozuar direktivën e re të Bashkimit European, si dhe disa aspekte të tjera të reflektuara gjatë procesit të punës.

Kjo ishte shkurtimisht një përmbledhje e raportit që ju kam paraqitur.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Dervishi!

Ka pyetje?

Fjalën e ka zonja Hysi dhe pastaj zonja Caka.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Komisioner, për raportin e detajuar!

Unë kam dy pyetje.

Pyetja e parë ka të bëjë me shqetësimin që ngritët për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”, megjithëse është një ligj i ri, domethënë ka vetëm dy muaj për periudhën që ju raportoni, por keni ngritur shqetësim për koordinatorët. A janë të ndërgjegjësuar institucionet për rëndësinë e këtij pozicioni dhe detyrimet që kanë, dhe çfarë keni bërë ju për përhapjen e informacionit dhe njohjen më të mirë të këtij ligji?

Pyetja e dytë ka të bëjë me marrëdhënien tuaj me AKEP-in. Ju thatë se keni marrëdhënie të mira, keni bashkëpunuar, por ndoshta ju ishit dëshmitarë. Pak minuta para se ju të fillonit seancën dëgjimore, kolegja jonë Bregu ka depozituar dy kërkesa për ndryshime në ligj, ku njëra prej tyre lidhet pikërisht edhe me rolin ose me kontributin që institucioni juaj ka luajtur ose mund të luajë. Bëhet fjalë për *web-et online* dhe lirinë e shprehjes që kanë njerëzit, si dhe cenimin e reputacionit, të nderit dhe të dinjitetit të tyre. A keni bërë ndonjë monitorim të faqeve *online* dhe a keni gjetur në këto faqe të dhëna të detajuara për administratorët e tyre, në kuadër të së drejtës së informimit, të drejta dhe detyrime që ato kanë dhe se si qytetarët mund të kontaktojnë me administratorët për shqetësimet që ato kanë, qoftë për të drejtën e informimit apo kur të dhënat e tyre personale deformohen, preken, cenohen e të tjera?

Pyetja tjetër që unë kam lidhet me shqetësimin që na lindi gjatë diskutimit të ndryshimeve të ligjit të Avokatit të Popullit dhe të ligjit tuaj. Si ka funksionuar bashkëpunimi me institucionin e Avokatit të Popullit?

Në raport ju thoni se keni katër ankesa që janë deleguar nga zyra e Avokatit të Popullit. Po ju nga ana juaj a i keni përcjellë informacione, shqetësime të cilat duhet të jenë në fokusin

e punës së Avokatit të Popullit kur bëjmë fjalë për monitorimin e së drejtës për informim? E them këtë, pasi Komisioni European kundër racizmit, tolerancës, e ka mbështetur këtë lloj krijimi, ndryshimi që ne bëjmë në ligj, duke ia dhënë të drejtën e informimit një institucioni tjetër të pavarur, që të vë edhe gjoba, por nga ana tjetër i ka kërkuar institucionit të Avokatit të Popullit të forcojë punën e tij për monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe atë të informimit në veçanti?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Unë besoj se lidhur me pyetjen që kishte të bënte me projektligjin, edhe vetë komisioneri do ta rezervojë të drejtën të mos përgjigjet këtu pa u njohur me materialin...

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Në rregull, por pa i hyrë thelbit të ligjit, se nuk mund ta pretendojmë ne këtë gjë sot.

Urdhëroni, zoti Komisioner!

Besnik Dervishi – Faleminderit, zoti kryetar!

Dëshiroj t’ju falënderoj, sepse projektligji është dërguar nga ana juaj për mendim, te ne ka mbërritur vetëm dje dhe ne e kemi futur në proces që sot! Natyrisht, në afatin e kërkuar do të japim edhe ne mendimin dhe vlerësimin e specializuar. Kjo është një praktikë tejet pozitive që Komisioni i Ligjeve ka krijuar dhe zhvillon duke marrë edhe mendimin e institucionit tonë, gjë që, për hir të së vërtetës, nuk ndodh me institucionet e tjera, pavarësisht se është detyrim i ligjit.

Për sa i përket caktimit të koordinatorëve, detyrim që buron nga ligji nr. 119 “Për informimin publik”, kjo ka qenë shumë pengesë, veçanërisht në fillim, por vazhdon të jetë edhe sot, sepse jo të gjitha autoritetet publike kanë arritur të caktojnë koordinatorin. Përse e them këtë? E them sepse koordinatori, në bazë të ligjit, është personi direkt përgjegjës për kryerjen e shumë detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në ligjin “Për të drejtën e informimit”. Megjithatë, ne menjëherë, që me hyrjen në fuqi të ligjit, kemi bërë listimin e të gjitha autoriteteve publike, ku kemi kërkuar edhe bashkëpunimin e Departamentit të Administratës Publike për institucionet që përfshihen në shërbimin civil, kemi renditur të gjitha institucionet e pavarura, të gjitha degët e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të gjithëve u kemi dërguar shkresë sensibilizuese për këtë gjë. një pjesë e mirë, rreth 200 institucioneve na janë përgjigjur duke e caktuar koordinatorin.

Besoj se sot, që unë po raportoj në komision, jemi në një pikë ku mund të vlerësohet pozitivisht, por veçanërisht dy muajt e parë, dy muajt e periudhës së raportimit 2014 dhe muaji janar kanë qenë tejet të vështirë për të pasur koordinatorin si pikë kontakti dhe për të koordinuar

për shqyrtimin e ankesave që kanë mbërritur pranë Zyrës së Komisionerit, për të cilët duhet thënë se në numër nuk kanë qenë të vogla pavarësisht se janë zgjidhur 100% e tyre.

Gjithashtu, në mes të muajit mars, gjithmonë në bashkëpunim dhe me mbështetjen edhe të fondacionit “Soros”, zhvilluam një trajnim me të gjithë koordinatorët e të gjitha institucioneve, e të gjitha autoriteteve publike. Ishte një trajnim mjaft i vlerësuar ku morën pjesë mbi 200 koordinatorë dhe titullarë administrativë institucionesh, të cilët ishin të ftuar të merrnin pjesë në këtë takim. Mendoj se sot jemi në një pikë shumë më pozitive me çfarë mund të reflektojë raporti deri në fund të vitit 2014.

Për sa u përket monitorimeve *online*, ne kryejmë inspekte *online*. Kjo është një praktikë e konsoliduar e institucionit. Natyrisht, jemi përpjekur ta zgjerojmë këtë dhe të mos mbetemi vetëm me inspekte *online*, si rezultat i të cilave ne japim rekomandime, por ne kemi verifikuar edhe *online*, edhe në vend zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Për sa u përket portaleve të ndryshme të lajmeve, gjë që lidhet edhe me të drejtën e informimit, që varej edhe me riorganizimin që iu bë AMA-s, ne kemi vendosur në bazë të iniciativës sonë kontaktin me AMA-n, është zhvilluar takimi i parë teknik dhe të dyja grupet e punës të të dy institucioneve janë duke vazhduar përgatitjen e materialeve dhe besoj se dotë konkludojë me hartimin e një Kodi Etik që do të vlejë për të gjithë sferën që përfshihet në këtë pikë, ku do të rregullojë pra edhe marrëdhëniet, edhe lajmet që do të publikohen nga portalet e ndryshme.

Për sa u përket marrëdhënieve me Avokatin e Popullit, unë mendoj se nga ana e institucionit që unë drejtoj nuk ka absolutisht asnjë lloj problemi, përkundrazi, ne jemi ofruar për një bashkëpunim.

Nga ana e Avokatit të Popullit është paraqitur një projekt marrëveshje për të bashkëpunuar edhe në krijimin e zyrave rajonale. Nga ana jonë janë bërë sugjerimet e nevojshme për të, ia kemi përcjellë me shumë pozitivitet Avokatit të Popullit, por ende nuk ka pasur një kontakt për sa i përket nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Ne jemi disponibël dhe të gatshëm.

Për sa u përket tarifimeve të çështjeve, edhe javën e kaluar ne kemi pasur një çështje që e kemi punuar dhe kontribuar së bashku për zgjidhjen e këtij problemi, pra është një bashkëpunim besoj i konsoliduar dhe i përditshëm. Është në funksion edhe të ecurisë pozitive të punës së të dyja institucioneve.

Natyrisht, besoj se nga ju domosdoshmërisht, por edhe nga të gjithë të tjerët, kuptohet se ndoshta vëmendja është përqendruar pak më tepër te Zyra e Komisionerit, sepse kjo Zyrë urdhëron, detyron, sanksionon, ndërsa Avokati i Popullit mbetet në funksionin e tij kushtetues,

me rekomandime. Kështu që për këtë arsye vëmendja e ankuesve dhe ankesat janë përqendruar pranë Zyrës së Komisionerit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Në fakt, në materialin e Shërbimit të Monitorimit më kanë lënë një shënim këtu që “duhet të vlerësojë rolin e komisionerit”, sepse ka futur një praktikë të re lidhur me raportimin e përmuajshëm mbi detyrat e realizuara pranë Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura. Këta më kanë lënë shënim që këtë duhet ta lexoj dhe unë e lexova.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Besoj se është edhe pozitive, domethënë një raport shumë i mirë ndërmjet institucionit dhe Shërbimit të Monitorimit, në mënyrë që edhe Shërbimi i Monitorimit të bëjë detyrën e tij dhe të jetë sa më realist.

Në raportin e përgatitur nga Shërbimi i Monitorimit ka disa rekomandime. Jeni njohur me to?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk jeni njohur me raportin e Shërbimit të Monitorimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull. Do të dëshiroja që ju ta merrnit raportin, sidomos në mënyrë të veçantë për këtë pjesën e rekomandimeve, sepse do të shërbejnë si bazë edhe për rezolutën që do të miratojë komisioni.

Klodi, meqenëse jemi këtu, do të vendosim dy rregulla, që nuk duhet të diskutohen më.

E para, institucionet që vijnë raportojnë duhet të njihen paraprakisht me të gjitha raportet që bën Shërbimi i Monitorimit. Është korrekte, siç ai ka sjellë raportin, duhet të dijë edhe se cili është vlerësimi që ka Shërbimi i Monitorimit për raportin e tij. Është efekt edhe korrekte, edhe institucionale, por edhe transparente.

E dyta, raporti i Shërbimit të Monitorimit të vijë i shoqëruar me një draftrezolutë. Si e mendojnë ata, nuk ka rëndësi, pastaj ngelet në çmimin e relatorit dhe të ligjvënësve nëse qëndron apo do ta bëjnë nga e para, apo do ta plotësojnë, që t'i japë mundësi edhe atij që vjen të relatojë që të thotë se “Unë mendoj që kjo nuk mund të jetë në rezolutë, se kjo është ose ka nevojë që kjo rezolutë të më ndihmojë mua”.

E treta, një nga përfaqësuesit e Shërbimit të Monitorimit të ulet gjithmonë aty kur ka ndonjë reagim të mundshëm. Dakord, Klodi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull. Faleminderit!

Ka ndonjë gjë tjetër nga kolegët?

E mbylлим këtu pjesën e raportimit, zoti Muçmataj, sepse pjesa e diskutimit do të jetë kur të paraqitet projektrezoluta? Kështu që bashkë me Shërbimin e Monitorimit përgatisni projektrezolutën për ta diskutuar javën e ardhshme në komision.

Ishte pozitive, siç thashë, që komisioneri, zoti Dervishi, të ishte i njohur me draftin dhe të bënte komentet e veta. Pastaj ngelet në çmimin e komisionit se cili do të jetë varianti apo ajo çka do të ketë në përmbajtje draftrezoluta që do t'i kalojë seancës plenare.

Faleminderit, zoti Dervishi!

Besnik Dervishi – Faleminderit juve!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit kolegëve!

Faleminderit juve të medias për durimin!

Mirupafshim nesër në seancë plenare!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

KQZ-ja nuk do të jetë, meqenëse opozita, që ta dijë edhe media, nuk ishte e pranishme dhe ne nuk mund ta trajtojmë KQZ-në pa opozitën. Nuk mund ta bëjmë dot këtë gjë!

MBLEDHJA MBYLLET